

PLANI STRATEGJIK CLR

2022-2026

Qershor 2022

Phone

+355 69 402 0057

Address

Rr."Frederik Shiroka" Pallati "Alba", Shk. 4, Ap. 7

Website

www.clr.al

TABELA E PËRMBAJTJES :

I. Hyrje - Metodologjia e punës.....	fq.
II. Profili i Organizatës.....	fq.
III. Projektet e Realizuara në Periudhën 2017-2021.....	fq.
IV. Filozofia e CLR për Planin Strategjik 2022-2026.....	fq.
1. Vizioni	
2. Misioni	
3. Vlerat	
V. Analiza e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm të organizatës.....	fq.
VI. Qëllimet dhe objektivat.....	fq.
a) Programet	
b) Shërbimet	
c) Menaxhimi	
VII. Skema e përgjithshme e drejtimeve strategjike të organizatës.....	fq.
VIII. Matrica e planit strategjik.....	fq.
IX. Plani i Zbatimit të Aktiviteteve.....	fq.

I. HYRJE - METODOLOGJIA E PUNES

Plani Strategjik i Qendrës për të Drejtat në Punë (CLR) për vitet 2022 – 2026, u hartua duke u bazuar në rezultatet dhe përvojat e fituara përgjatë 5 viteve të mëparshme si dhe në tendencat e reja në fushën e mbrojtjes së të drejtave të punonjësve. Përvojat e mëparshme shërbyen si një mjet udhëheqës në punën e organizatës, duke i dhënë asaj drejtimet e së nesërme si dhe mënyrën e realizimit të objektivave të përcaktuara.

Hartimi i planit strategjik u realizua pas një procesi të gjatë komunikimi dhe bashkëbisedimi me bordin e drejtorëve, stafin dhe partnerët e organizatës. Prosesi i hartimit përfshiu vlerësimin & sugjerimet e përfituesve, organizatave/sindikatave partnere, institucioneve të linjës, si dhe konkretizimin e tyre nga grupi i punës.

Procesi i planifikimit dhe përgatitjes së këtij dokumenti kaloi në disa hapa mjaft të rëndësishëm si:

1. Vlerësimi i arritjeve të 5-vjeçarit të mëparshëm;
2. Workshop i Planifikimit Strategjik dhe hartimi i draftit të parë;
3. Hartimi i draftit të dytë të Planit Strategjik;
4. Paraqitja e draftit të Planit Strategjik Bordit të Drejtorëve dhe partnerëve strategjik;
5. Miratimi i Planit Strategjik.

Hapi i parë: Vlerësimi i arritjeve të 5-vjeçarit të mëparshëm

Për vlerësimin e arritjeve të 5-vjeçarit të mëparshëm grupi i punës organizoi 4 takime në të cilat u diskutua mënyra e organizimit të 5 fokus-grupeve, si dhe përzgjedhjen e personave të përfshirë në këtë proces.

Me mbështetjen e organizatës partnere ne Afrikën e Jugut, LRS dhe ekspertit të saj u realizua analiza SWOT, ku të gjithë përfituesit dhe aktorët ofruan vlerësimet e tyre në lidhje me punën e organizatës, ashtu sikurse ide dhe sugjerime se ku CLR duhet t'i fokusojë programet/shërbimet në 5-vjeçarin e ardhshëm.

Pyetësori përfshinte këto pyetje:

1. Cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të organizatës?
2. Çfarë shikoni si mundësi dhe pengesa të organizatës?
3. Cilat janë kriteret që ju përdorni kur gjykoni rreth punës së organizatës?
4. Si kanë qenë rezultatet e organizatës bazuar në kriterin (ose kriteret) që ju keni përdorur për të vlerësuar punën e saj?
5. Çfarë do të dëshironit që organizata të bënte më shumë ose më pak?
6. Në cilat programe dhe/ose shërbime mendoni se duhet të përqëndrohet organizata nëse ka burimet e mjaftueshme në tre/pesë vjeçarin e ardhshëm?

Pas grumbullimit të informacionit nëpërmjet fokus grupeve u bë përpunimi dhe analizimi paraprak i informacionit nga grupi i punës.

Hapi i dytë: Workshop i Planifikimit Strategjik dhe hartimi i draftit të parë

Drafti i parë i Planit Strategjik u hartua gjatë workshop-it në të cilin u analizua informacioni i gjeneruar paraprakisht rreth pikave të forta e të dobëta të organizatës, rreth nevojave të komunitetit dhe mundësive për të ardhmen.

Gjatë workshop-it grupi i punës punoi mbi:

- Vlerësimin e arritjeve të 5-vjeçarit paraardhës dhe përvojave pozitive;
- Rishikimin e misionit dhe vizionit të organizatës;
- Përcaktimin e vlerave të organizatës;
- Analizën e brendshme dhe të jashtme të organizatës;
- Identifikimin e çështjeve kritike dhe strategjive të përgjithshme;
- Përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave për programet, shërbimet dhe menaxhimin;
- Përcaktimin e aktiviteteve kryesore;
- Vlerësimin e rreziqeve dhe formulimin e supozimeve.

Në workshop morën pjesë 8 persona. Pjesëmarrësit u pajisën me dokumentacionin e nevojshëm, si dokumenta strategjike të organizatës, raporte narrative vjetore dhe informacionin e përmbledhur nga fokus grupet dhe intervistat.

Hapi i tretë: Hartimi i draftit të dytë të Planit Strategjik

Grupi i punës, zhvilloi më tej draftin e dytë të planit strategjik duke përcaktuar qartë vizionin, misionin, çështjet kritike, qëllimet, objektivat dhe aktivitetet.

Gjithashtu, u hartua Matrica e Zbatimit Strategjik dhe Plani i Aktiviteteve për periudhën 2022-2026.

Hapi i katërt: Paraqitja/reflektimi i draftit të Planit Strategjik Bordit të Drejtorëve dhe partnerëve strategjike

Drafti i Planit Strategjik u paraqit në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve ku u sugjeruan mendime për përmirësime të mëtejshme. Ky draft u konsultua edhe me partnerët strategjike të CLR - së. Sugjerimet e bëra nga Bordi i Drejtorëve dhe partnerët strategjike u reflektuan në Planin Strategjik.

Hapi i pestë: Miratimi i Planit Strategjik

Dokumenti përfundimtar i Planit Strategjik 2022-2026 u prezantua tek organi më i lartë vendim-marrës i organizatës, i cili e miratoi dhe e kaloi për zbatim.

Ky Plan Strategjik synon të zgjerojë dhe të konsolidojë ekspertizën e organizatës në fushën e mbrojtjes së të drejtave të punonjësve, si dhe të fuqizojë kapacitetet menaxhuese, rrjetëzimin dhe vizibilitetin e organizatës.

Gjithashtu, ky Plan Strategjik do t'i shërbejë CLR-së si një udhërrëfyes në gjetjen e zgjidhjeve optimale për përfituesit, forcimin e bashkëpunimit efektiv me institucionet e linjës, si dhe në gjetjen e mënyrave për të arritur qëllimet dhe objektivat e saj në 5-vjeçarin e ardhshëm.

II. PROFILI I ORGANIZATES




Qendra për të Drejtat në Punë (CLR) është një organizatë jo-fitimprurëse kombëtare e specializuar për të drejtat në punë, themeluar me datë 20 Dhjetor 2016, me vendim të Gjykatës së Tiranës Nr. 1134.

CLR ka për qëllim të mbështesë dhe të angazhohet në programe dhe projekte që u mundësojnë punonjësve të ushtrojnë të drejtat e tyre në mënyrë që të:

- i) përmirësojnë kushtet e tyre të punës dhe të jetesës;
- ii) të nxisë dhe mbrojnë të drejtën e asociimit dhe të promovojë punë të denjë, drejtësi sociale dhe barazi për zhvillimin e qëndrueshëm demokratik të shoqërisë shqiptare.

CLR punon me punonjësit, sindikatat, këshillat e punëtorëve, këshillat e sigurisë dhe shëndetit në punë, shoqërinë civile, grupe të ndryshme interesi, institucione shtetërore, universitete shtetërore dhe private, organizata të punëdhënësve ose / dhe subjekte biznesi, institucione të tjera shtetërore ose private të kërkimi dhe edukimi.

CLR është një organizatë e orientuar drejt shërbimeve si më poshtë:

-  *Këshillim Ligjor dhe asistencë organizative;*
-  *Akademia e Punës, e fokusuar te edukimi i sindikalistëve dhe aktivistëve të rinj në çdo sektor të ekonomisë;*
-  *Këshillim dhe mbështetje për punëtorët, sindikatat, këshillat e punëtorëve, Këshillat e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe / ose me të gjitha grupet e organizuara të punëtorëve në cdo nivel.*

OBJEKTIVAT KRYESORE:

- Të inkurajojë, koordinojë dhe asistojë organizata të ndryshme shoqërore që ushtrojnë veprimtari në fushën e marrëdhënieve të punës dhe dialogut social përmes mbështetjes dhe ndihmës në veprimet civile ose ligjore.
- Të forcojë dhe sigurojë mbështetje ligjore, administrative dhe ndërtimin e kapaciteteve për sindikatat në nivelet e ndërmarrjeve, sektorëve dhe federatave.
- Të promovojë punë të denjë dhe të çojë përpara lëvizjen e punës përmes informacionit, edukimit dhe ndërgjegjësimit në komunitete të ndryshme të punës dhe publikut të gjerë në përgjithësi.

- Të trajnojë dhe edukojë anëtarët / udhëheqësit ekzistues dhe potencialë të mëtejshëm të sindikatave

AKTIVITETET KRYESORE:

- Mbështetja dhe asistimi i sindikatave ose / dhe grupeve të punonjësve në zgjidhjen kolektive të mosmarrëveshjeve.
- Mbështetja dhe organizimi i punonjësve, fushata sensibilizuese, tubime, greva, protesta, manifestime dhe çdo angazhim tjetër qytetar në përputhje me misionin e qendrës.
- Këshillimi dhe asistimi i punonjësve për të adresuar në strukturat kompetente çdo shqetësim në lidhje me mosrespektimin e legjislacionit shqiptar të punës, të tilla si: mosdhënia e lejeve, pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në përputhje me ligjin ose kontratën e punës, mosrespektimi i shëndetit sigurimi dhe siguria në punë, konfliktet dhe abuzimet e ndodhura në vendin e punës, largimet e padrejta dhe të pamotivuara, etj.
- Aktivitete të informacionit, edukimit dhe ndërgjegjësimit të krijuara për të përmbushur nevojat e komuniteteve që punojnë dhe shoqërisë shqiptare në përgjithësi duke përdorur platforma dhe produkte mediatike, etj.
- Ndërmarrja e sondazheve në ndërmarrjet / degët e veprimtarisë / sektorët e ekonomisë dhe kategoritë e zgjedhura të punonjësve për të kuptuar nivelin e respektimit të të drejtave të punëtorëve dhe zbatueshmërinë e skemave të përgjegjësisë së biznesit shoqëror.

HISTORI SUKSESI:

- ✓ CLR ka ndihmuar punonjësit e naftës dhe gazit që të organizohen në një sindikatë të re kombëtare, "Sindikata e Naftës dhe Gazit e Shqipërisë", e cila është një nga anëtarët e rinj të Këshillit Kombëtar të Punës (organi më i lartë të dialogut shoqëror në Shqipëri) falë lobimit të CLR.
- ✓ CLR ka asistuar punonjësit e sektorit të qendrave të thirrjeve(Call Center) për t'u organizuar në një sindikatë të re "Sindikata Kombëtare e Operatorëve Telefonik SKOT", e cila tani po përhapet në të gjithë sektorin call center dhe komunikacion.
- ✓ CLR ka ndihmuar me sukses punonjësit e sektorit shëndetësor që të organizohen në një sindikatë të re "Sindikata e Punonjësve të Sektorit të Shëndetësisë". Gjatë kohërave pandemike, në korrik të vitit 2020, me mbështetjen dhe mentorimin e CLR, sindikata protestoi për përmirësimin e kushteve të punës dhe pagave. Për shkak të bërjes mediatike të protestës,

përfaqësuesit e Kryeministrisë dhe Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u takuan me përfaqësuesit e sindikatës. MSHMS më vonë filloi procesin e negociatave me sindikatën për sa i përket pagave dhe kushteve të shëndetit dhe sigurisë. Ministria tashmë ka krijuar grupet e përbashkëta të punës, në të cilat mungojnë përfaqësuesit e sindikatës aktuale që ka nënshkruar marrëveshjen kolektive kombëtare.

- ✓ CLR ka krijuar dhe drejtuar me sukses "Akademinë e Punës" programin e vetëm të trajnimit aktiv në vend kushtuar edukimit të vazhdueshëm të sindikalistëve të rinj dhe aktivistëve të punës. Nëpërmjet Akademisë së Punës nga CLR trajnohen çdo vit me një kurrikul 1 vjecare rreth 20 sindikalistë dhe aktivistë të të drejtave në punë. Aktualisht rreth janë trajnuar rreth 40 aktivistë ndërkohë që 20 janë në proces.
- ✓ CLR është anëtare e Këshillit Kombëtar të Integritit European dhe jep ndihmesën e saj në KKIE për kapitujt 14,15,16,19.
- ✓ CLR është anëtare e Grupit Ndër-institucional të Punës mbi zbatimin e platformës së partneritetit për integrimin european për kapitullin 19 "Politikat sociale dhe punësimi" të ngritur pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- ✓ CLR është anëtare e Grupit Ndëri-nstitucional të Punës mbi zbatimin e platformës së partneritetit për integrimin european për kapitullin 2 "Levizja e lire e punetoreve" të ngritur pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

DONATORE DHE PARTNERITETE:

- ❖ CLR ka një shtrirje të gjerë të rrjetëzimit dhe bashkëpunimit me të gjitha sindikatat në Shqipëri, institucionet publike, organizatat, kompanitë e biznesit, shoqërinë civile, si dhe me subjekte ose individë të tjerë brenda dhe jashtë vendit. Donatori dhe partneri ynë kryesor është Olof Palme International Center, me fonde të Qeverisë së Suedisë.
- ❖ CLR është anëtare e Këshillit Kombëtar të Integritit European dhe jep ndihmesën e saj në KKIE për kapitujt 14,15,16,19.
- ❖ CLR është anëtare e Grupit Ndër-institucional të Punës mbi zbatimin e platformës së partneritetit për integrimin european për kapitullin 19 "Politikat sociale dhe punësimi" të ngritur pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- ❖ CLR është anëtare aktive e Fushatës së Rrobave të Pastra (CCC), një rrjet global i dedikuar për përmirësimin e kushteve të punës dhe fuqizimin e punëtorëve në industrinë globale të veshjeve dhe atyre sportive. Që nga viti 1989, ka punuar për të siguruar respektimin e të drejtave themelore të punëtorëve. Fokus i punës është edukimi dhe mobilizimi i konsumatorëve, llojve dhe mbështetje e drejtpërdrejtë e punëtorëve për të drejtat e tyre dhe kushte më të mira të punës. CCC është një rrjet themelor i qindra organizatave dhe sindikatave që identifikojnë problemet dhe objektivat lokale dhe i transformojnë ato në veprime globale, zhvillojnë strategji fushate për të mbështetur punëtorët në arritjen e qëllimeve të tyre dhe gjithashtu bashkëpunojnë gjerësisht me fushata të ngjashme për të drejtat e punës. <https://cleanclothes.org/>
- ❖ CLR është anëtare e sapopranuar e SOLIDAR, rrjeti më i madh evropian dhe botëror i organizatave që punojnë për të avancuar drejtësinë sociale në Evropë dhe në gjithë botën. Ky rrjet bashkon 60 organizata anëtare nga 25 shtete anëtare të BE-së dhe nga 6 vende kandidatë, që punojmë së bashku në Çështjet Sociale, Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Edukimin dhe Mësimin Gjatë Gjithë Jetës. SOLIDAR bashkëpunon me shoqërinë civile dhe organizatat e punonjësve, angazhohet përmes tyre me qytetarët në proceset e vendimmarrjes së BE-së, fuqizon njerëzit përmes mësimin gjatë gjithë jetës dhe u shpreh shqetësimet e tyre institucioneve të BE-së, kryen lobim, menaxhim dhe koordinim të projektit, monitorim politikash, hulumtim dhe ngritja të vetëdijes etj. <https://www.solidar.org/en/about-us/solidar>

III. PROJEKTET E REALIZUARA NË PERIUDHËN 2017-2021

NR.	TITULLI I PROJEKTIT	DONATORI	VITET E ZBATIMIT
1.	Agjenda e punës së denjë në Programet Zgjedhore të Partive	Olof Palme International Center me fondet e Qeverisë Suedeze	2017
2.	Projekte në mbështetje të punonjësve në Fasoneri për rajonin e Vlorës.	Olof Palme International Center me fondet e Qeverisë Suedeze	2018
3.	Projekte në mbështetje të punësimit të grave në rajonin e Patosit	Qeveria Norvegjeze	2019
4.	Promovimi i të Drejtave të Punës dhe Mbështetja për Sindikatat	Olof Palme International Center me fondet e Qeverisë Suedeze	2017-2019
5.	"Drejt përmirësimit të shëndetit dhe sigurisë në punë në Ballkanin Perëndimor",	Olof Palme International Center me fondet e Qeverisë Suedeze.	2018-2019
6.	Projekte në mbështetje të punonjësve të rinj në fushën e arsimit profesional.	Olof Palme International Center me fondet e Qeverisë Suedeze me partner Liburnetik	2020-2021
7.	Fuqizimi i Punës së Grave të Reja përmes Mësimit Joformal	Programi Erasmus + me fondet e BE-së në partneritet me organizata në Francë, Turqi, Bullgari	2019-2021
8.	Përmirësimi i dialogut social dhe i politikave tëpunësimit në Shqipëri në funksion të procesit të integrimit në BE	Bashkimi Evropian, skemat e dhënies së granteve IPA 2015	2018 -2020
9.	Promovimi i të Drejtave të Punës dhe Fuqizimi i Lëvizjes së Punës në Shqipëri	Olof Palme International Center me fondet e Qeverisë Suedeze	2020 - ne vazhdim
10	STOP ngacmimit dhe dhunës në vendin e punës	Olof Palme International Center me fondet e Qeverisë Suedeze	2020-2021

IV. FILOZOFIA E CLR PËR PLANIN STRATEGJIK 2022-2026

1. Vizioni i organizatës

Zhvillimi dhe fuqizimi i të drejtave të punëtorëve, nxitja e integritit dhe përfshirjes së tyre sociale duke promovuar punë të denjë dhe kushte të denja për të jetuar në Shqipëri.

2. Misioni i organizatës

Të mbështesë dhe të angazhohet në programe dhe projekte që u mundësojnë punonjësve të ushtrojnë të drejtat e tyre në mënyrë që të:

- i) përmirësojnë kushtet e tyre të punës dhe të jetesës;
- ii) të nxisë dhe mbrojë të drejtën e asociimit dhe të promovojë punë të denjë, drejtësi sociale dhe barazi për zhvillimin e qëndrueshëm demokratik të shoqërisë shqiptare.

3. Vlerat e organizatës

- **Humanizmi:** Ne drejtohem nga interesat, vlerat dhe dinjiteti ndaj njerëzve.
- **Toleranca:** Ne dëgjojmë dhe pranojmë pa diskriminuar.
- **Ndjeshmëria:** Ne trajtojmë çdo person me respekt dhe dinjitet.
- **Përgjegjshmëria:** Ne përdorim në mënyrë efektive burimet njerëzore dhe financiare.
- **Mikpritja:** Ne karakterizohemi nga ndjenja e mikpritjes.
- **Gadishmëria:** Ne jemi të gatshëm në çdo kohë që na kërkohet ndihmë.
- **Këmbëngulja:** Ne jemi insistues dhe këmbëngulës në arritjen e qëllimeve dhe misionit tonë.
- **Përkushtimi:** Të dedikuar për misionin tonë.
- **Bashkëpunimi:** Ne punojmë në partneritet në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- **Vullnetarizmi:** Ne ofrojmë ekspertizën tonë.
- **Efektiviteti:** Ne ofrojmë shërbime cilësore në përputhje me nevojat e përfituesve.
- **Anti-Korrupsion**
- **Parimi Anti-Diskriminin**
- **Parandalimi i Ngacmimit dhe Abuzimit Seksual**
- **Profesionalizmi**
- **Puna në grup**
- **Qëndrueshmeria**
- **Llogaridhënia**
- **Legjitimiteti**

V. ANALIZA E MJEDISIT TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM TË ORGANIZATËS

	Pikat e forta	Pikat e dobëta
Mjedisi i brendshëm	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Lidërsip efektiv; ▪ Staf teknik kompetent dhe profesional; ▪ Struktura organizative efektive; ▪ Organizatë serioze dhe me reputacion pozitiv; ▪ Të qëndruarit brenda misionit; ▪ Vizibiliteti në media vizive dhe të shkruara, sidomos në media sociale; ▪ Organizatë me një mendësi të hapur, mikpritës, mosdiskriminues; ▪ Aktivë në programe Advokacie & Lobimi për të drejtat në punë ▪ CLR është partnere, anëtare e rrjeteve ndërkombëtare si CCC dhe Solidar ▪ CLR është anëtare e Komisioneve për Integrimin dhe pjesë e proceseve konsultative ▪ Pajisje zyre të mjaftueshme për një aktivitet normal; 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shërbime dhe programe të pamjaftueshme në lidhje me çështjet e punës; ▪ Mungesa e ambjenteve të qëndrueshme për zhvillimin e punës së organizatës; ▪ Aftësi të pamjaftueshme për ngritjen e fondeve; ▪ Mungesa e aftësive dhe strukturës të IT-s; ▪ Shtrirja gjeografike e pa mbështetur me staf në rrethe; ▪ Institucionalizimi jo i mjaftueshëm i marrëdhënieve me institucione publike dhe jo-publike; ▪ Institucionalizimi jo i mjaftueshëm i marrëdhënieve me median;
Mjedisi i jashtëm	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Njohja e nevojave të komunitetit sipas misionit tonë; ▪ Nevoja për shërbimet e organizatës në nivel kombëtar; ▪ Bashkëpunim me institucionet qëndrore, lokale, OJF, median; ▪ Ratifikimi i konventave për çështjet e punës; ▪ Ka organizata ndërkombëtare që advokojnë për të drejtat në punë ▪ Ekzistojnë ekspertë të jashtëm/organizata që ofrojnë mbështetje për rritjen e kapaciteteve të stafit; ▪ Ekzistenca e donatorëve që financojnë programe për çështjet e punës 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hendeku midis ligjislacionit në fuqi dhe zbatimit të tij si pasojë e kapaciteteve të pamjaftueshme të institucioneve publike; mungesë dhe paqëndrueshmëri në burime njerëzore dhe financiare; ▪ Varësia nga fondet e donatorëve të huaj për shkak të mos-financimit nga institucionet shtetërore; ▪ Bazë ligjore e paspecifikuar për tenderimin e shërbimeve të ofruara nga OJF-të; ▪ Konkurrencë informale dhe e pandershme (korrupsioni, rryshfeti, njohja, etj.); ▪ Mungesa e besimit nga komuniteti për përmirësimin e çështjeve të lidhura me punën

VI. QELLIMET DHE OBJEKTIVAT

A. PROGRAMI: SHERBIMI

Qëllimi strategjik: Ofrimi i këshillimit ligjor dhe asistencës organizative

- A1. **Objektivi:** Të inkurajojë, koordinojë dhe asistojë organizata të ndryshme shoqërore që ushtrojnë veprimtari në fushën e marrëdhënieve të punës dhe dialogut social përmes mbështetjes dhe ndihmës në veprimet civile ose ligjore.
- A2. **Objektivi:** Të forcojë dhe sigurojë mbështetje ligjore, administrative për sindikatat në nivelet e ndërmarrjeve, sektorëve dhe federatave.

B. PROGRAMI: EDUKIMI

Qëllimi strategjik: Edukimi i sindikalistëve dhe aktivistëve të rinj në cdo sektor të ekonomisë

- B1. **Objektivi:** Të trajnojë dhe edukojë anëtarët / udhëheqësit ekzistues dhe potencialë të mëtejshëm të sindikatave
- B2. **Objektivi:** Të promovojë punë të denjë dhe të çojë përpara lëvizjen e punës përmes informacionit, edukimit dhe ndërgjegjësimit në komunitete të ndryshme të punës dhe publikut të gjerë në përgjithësi.

C. PROGRAMI: LOBIMI

Qëllimi strategjik: Mbrojtja e të drejtave të punonjësve

- C1. **Objektivi:** Të promovojë punë të denjë dhe të çojë përpara lëvizjen e punës përmes informacionit, edukimit dhe ndërgjegjësimit në komunitete të ndryshme të punës dhe publikut të gjerë në përgjithësi.
- C2. **Objektivi:** Rritja e kapaciteteve të institucioneve shtetërore dhe joshtetërore për zbatimin efektiv të politikave ekzistuese kombëtare për punën
- C3. **Objektivi:** Përmirësimi i mekanizmave ligjorë për parandalimin e abuzimit, ngacmimit seksual dhe diskriminimit në vendin e punës nëpërmjet përfshirjes në iniciativa kombëtare e ndërkombëtare advokuese

	<u>Menaxhimi: Qëllimet</u>	<u>Menaxhimi: Objektivat</u>
1. Stafit dhe përfitimet	Staf profesional dhe i përkushtuar për realizimin e misionit dhe vizionit të CLR-së	1.1 Gjetja e metodave efikase për përzgjedhjen e stafit 1.2 Rritja e vazhdueshme e kapaciteteve 1.3 Gjetja e alternativave efektive për lehtësimin e mbingarkesës në punë të stafit 1.4. Rritja e mirëqënies psiko- emocionale të stafit
2 Qëndrueshmëria	Qëndrueshmëri afatgjate financiare e CLR-së	1.1 Diversifikimi/Sigurimi i të ardhurave nga burime të ndryshme 1.2 Gjetja/përdorimi i hapësirave ligjore për mbështetjen financiare të aktiviteteve social-ekonomike dhe vecanërisht ndërmarrjeve sociale 1.3 Rritja e numrit të anëtarësimit në sindikata
2. Organi Ekzekutiv	Pjesëmarrje aktive e Bordit në përmbushje të misionit të CLR-së	1.1 Takime periodike të bordit 1.2 Gjetja e donatorëve potencialë për organizatën 1.3 Lobimi në nivele të larta për organizatën
3. Planifikimi dhe vlerësimi	Përmirësim i vazhdueshëm i veprimtarisë së CLR-së	4.1 Vendosja e sistemeve të Planifikimit, Monitorimit & Vlerësimit 4.2 Përditësimi dhe rishikimi i Planit Strategjik, Statutit, Manualit i Politikave dhe Procedurave Financiare, Manualit të Prokurorimeve, Rregullores së Brendshme, Politikave të Anti-Korrupsionit, Parandalimit të Abuzimit dhe Ngacimit Seksual

5 Marrëdhënie t publike/ Marketingu	Forcimi i imazhit publik të CLR-së	5.1 Hartimi i një Politike Marketingu për Marrëdhëniet me Publikun që përfshin: <ul style="list-style-type: none"> • përditësimi i website • mediat sociale • mediat lokale vizive dhe të shkruara (emisione, intervista, shkrime) • përgatitja dhe shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuese 5.2 Përcaktimi i personit/ave përgjegjës për Marrëdhëniet me Publikun 5.2. Mirëfunksionimi i strukturës për MP
6 Infrastruktura	Infrastruktura efektive dhe eficiente për veprimtarinë e organizatës.	6.1. Përdorimi efektiv i aseteve materiale dhe jo materiale të organizatës 6.2. Plotësimi i infrastrukturës për realizimin e aktiviteteve të organizatës 6.3. Përmirësimi infrastrukturës IT për analizën, përpunimin, raportimin e të dhënave
7 Rrjetet dhe bashkëpunimet	Unifikim dhe zgjerim të veprimeve të përbashkëta për çështjet të punës	7.1. Përfshirja e CLR-së në rrjete kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare

VII. DREJTIMET E PËRGJITHSHME STRATEGJIKE QENDRA PER TE DREJTAT NE PUNE 2022 – 2026

VIZIONI						
Zhvillimi dhe fuqizimi i të drejtave të punëtorëve, nxitja e integritimit dhe përfshirjes së tyre sociale duke promovuar punë të denjë dhe kushte të denja për të jetuar në Shqipëri.						
MISIONI						
Të mbështesë dhe të angazhohet në programe dhe projekte që u mundësojnë punonjësve të ushtrojnë të drejtat e tyre në mënyrë që të:						
i) përmirësojnë kushtet e tyre të punës dhe të jetesës;						
ii) të nxisë dhe mbrojtë të drejtën e asociimit dhe të promovojë punë të denjë, drejtësi sociale dhe barazi për zhvillimin e qëndrueshëm demokratik të shoqërisë shqiptare.						
PROGRAMET						
A. SHËRBIMET		B. EDUKIMI			C. LOBIMI	
Qëllimet sipas programeve						
Ofrimi i këshillimit ligjor dhe asistencës organizative		Edukimi i sindikalistëve dhe aktivistëve të rinj në cdo sektor të ekonomisë			Mbrojtja e të drejtave të punonjësve	
MENAXHIMI						
Stafi	Zhvillimi i burimeve	Bordi	Planifikimi & vlerësimi	M.publike/ marketing	Infrastruktura	Rrjetet
Staf profesional dhe i përkushtuar për realizimin e misionit dhe vizionit të CLR-së	Qëndrueshmëri afatgjatë financiare e CLR-së	Pjesëmarrje aktive e bordit në përmbushjen e misionit të CLR-së	Përmirësim i vazhdueshëm i veprimtarisë së CLR-së	Forcimi i imazhit publik të CLR-së	Infrastrukturë efektive dhe efçente për veprimtarinë e organizatës.	Unifikim dhe zgjerim të veprimeve të përbashkëta për çështjet e punës

VIII. MATRICA E PLANIT STRATEGJIK

Objektivat e programit	Indikatorët	Baseline	Mjetet e verifikimit
<p>Të kontribuojë në arritjen e respektimit të të drejtave të punës, përmes bashkëpunimit dhe mbështetjes së lëvizjeve ekzistuese apo të reja të punës me kapacitete të përmirësuara për t'u angazhuar me institucionet.</p>	<p>Indikatori 1: Rritja e nivelit të zbatimit të të drejtave të punës Objektivi: Mesatarisht në të kënaqshme Indikatori 2: Përmirësimi i përfshirjes dhe bashkëpunimit ndërmjet sindikatave Objektivi: Bashkëpunimi ndërmjet sindikatave u materializua</p>	<p>Korniza legjislative është përmirësuar, por problemet mbeten me zbatimin. Mungesa e sindikatave të organizuara efektive në nivel profesioni dhe niveli bazë Mungesa e burimeve njerëzore të kualifikuara të cilat janë pjesë e strukturave kolektive Ka 90 organizata duke përfshirë sindikatat, federatat dhe konfederatat</p> <p>Niveli i ulët i bashkëpunimit ndërmjet sindikatave Mungesa e bashkëpunimit formal ndërmjet sindikatave dhe punëdhënësve veçanërisht në sektorin privat.</p>	<p>Raporte kombëtare dhe ndërkombëtare për marrëdhëniet e punës dhe statusin e të drejtave të punës në Shqipëri; Raporti vjetor i ILO-s; Sindikatat e regjistruara; Raportet dhe informacionet e sindikatave; Raporte të Avokatit të Popullit</p>
<p>Objektivi i ndërmjetëm 1</p> <p>Forcimi dhe ofrimi i mbështetjes ligjore, administrative dhe për</p>	<p>Indikatori 1: Mirë-funksionimi i sindikatave me manuale dhe aktivitete të qarta për të ushtruar rolin dhe përgjegjësitë e tyre</p>	<p>Sindikatat e sapokrijuara duhet ende të luajnë rolin e tyre dhe të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre.</p>	<p>Raportimi i CLR Raportet e Monitorimit dhe Vlerësimit të Brendshëm; Monitorimi dhe vlerësimi i OPIC;</p>

<p>ngritjen e kapaciteteve për sindikatat e sapokrijuara në partneritet me CLR dhe sindikatat e tjera në nivele të ndërmarrjeve, sektorëve dhe federatave duke synuar rritjen e numrit të grave në strukturat drejtuese</p>	<p>Objektivi: Përfituesit janë në pozitë më të mirë dhe të mirënjohur për rolin e tyre Indikatori 2: Numri i grave të regjistruara në sindikata dhe numri i grave në strukturat drejtuese Objektivi: Ofrimi i ndihmës për strukturën e organizuar dhe kolektive në sektorin e shëndetësisë.</p>		<p>Feedback nga partnerët, palët e interesuara dhe përfituesit;</p>
<p>Objektivi i ndërmjetëm 2 Ofrimi i këshillimit të dedikuar, këshillimit ligjor dhe përfaqësimit për punonjësit individualisht ose kolektivisht në rast situatash konfliktuale me punëdhënësit privatë ose publikë në sektorët e hidrokarbureve, minierave, transportit, shërbimeve publike shëndetësore dhe industrisë së veshjeve;</p>	<p>Indikatori 1: Numri i rasteve të trajtuara nga CLR Objektivi: numri i rasteve kolektive ose individuale të trajtuara gjatë vitit të parë Indikatori 2: Numri i takimeve të realizuara me sindikatat dhe organizatat e tjera Objektivi: Takime mujore me sindikatat Indikatori 3: Mbështetje për çdo iniciativë të mundshme për krijimin e një sindikate të re Objektivi: takimet; numri i kontratave kolektive të asistuara Indikatori 4: numri i aktiviteteve të përbashkëta me sindikatat Objektivi: 6 aktivitete të përbashkëta</p>	<p>Sindikatat e reja në nivel ndërmarrjesh dhe sektori janë mbështetur në aktivitetet e tyre Asistencë dhe mbështetje për Shoqatat Shqiptare të Infermierëve, Urdhrin e Mjekëve të Mjekësisë dhe Urdhrin e Infermierëve</p>	<p>Raportimi i CLR Raportet e Monitorimit dhe Vlerësimit të Brendshëm; Monitorimi dhe vlerësimi i OPIC; Feedback nga partnerët, palët e interesuara dhe përfituesit;</p>

<p>Objektivi i ndërmjetëm 3 Forcimi i Qendrës/Akademisë së Trajnimit për Marrëdhëniet e Punës në shërbimin si qendër burimore për sindikatat në nivele të ndryshme dhe fuqizimi i drejtuesve të ardhshëm të sindikatave;</p>	<p>Indikatori 1: Akademia e Punës vazhdon funksionimin sipas parashikimeve Objektivi: Njihet plotësisht nga sindikatat dhe përfshihet në axhendën e tyre. Objektivi: Numri i personave të trajnuar dhe certifikuar Indikatori 2: Numri i veprimeve/iniciativave të sindikatave të përzgjedhura të mbështetura nga CLR Objektivi: të paktën gjashtë veprime/iniciativa</p>	<p>Veprimet e ndërmarra kanë të bëjnë me çështjet dhe sfidat kryesore me të cilat përballen sindikatat në mjedisin e tyre specifik</p>	<p>Raportimi i CLR Raportet e Monitorimit dhe Vlerësimit të Brendshëm; Monitorimi dhe vlerësimi i OPIC; Feedback nga partnerët, palët e interesuara dhe përfituesit; Feedback nga sindikatat e përgjedhura;</p>
--	--	--	---

MENAXHIMI

1. MENAXHIMI I STAFIT DHE PERFITIMET

Qëllimet	Objektivat	Treguesit	Burimet e verifikimit	Aktivitetet kryesore	Supozimet
<p align="center">Staf profesional dhe i përkushtuar për realizimin e misionit dhe vizionit të CLR-së</p>	<p>1.1 Gjetja e metodave efikase për përzgjedhjen e stafit</p>	<p>Nr. i pozicioneve të punës ku janë përcaktuar qartë kriteret/ detyrat/ përgjegjësitë Dokument me një metodologji efektive për përzgjedhjen e stafit</p>	<p>Dokumentet për çdo pozicion pune Njoftimet dhe publikimet për çdo pozicion të ri Dokumenti me metodologjinë e përzgjedhjes së stafit</p>	<p>1.1.1 Përcaktimi i kriterëve/detyrave/përgjegjësiv e për çdo pozicion pune 1.1.2 Bërja publike e çdo pozicioni në mediat sociale, të shkruara, vizive 1.1.3 Përcaktimi i metodologjisë për përzgjedhjen e kandidaturave</p>	<p>Shkëmbim eksperiencash me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare</p>
	<p>1.2 Rritja e kapacitetit profesional të stafit</p>	<p>Nr. i trajnimeve të ofruara brenda dhe jashtë vendit Nr. i aktiviteteve që ndikojnë në rritjen e kapaciteteve të stafit (konferenca, emisione mediatike, seminare, workshop-e, organizimi i tubimeve publike etj)</p>	<p>Foto Listë prezencë Materialet e trajnimit Video/ Punime shkencore Raporte/studime</p>	<p>1.2.1 Trajnime të vazhdueshme të stafit 1.2.2 Ndjekja e aktiviteteve që ndikojnë në rritje të kapaciteteve (brenda dhe jashtë Shqipërisë) 1.2.3 Shkëmbimi i përvojave të punës brenda dhe jashtë stafit</p>	<p>Shkëmbim eksperiencash me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare</p>

	1.3 Gjetja e alternativave efektive për lehtësimin e mbingarkesës në punë të stafit	Nr. i vlerësimeve të realizuara dhe obj. vjetor të hartuara për çdo punonjës Orar i punës fleksibël në përputhje me nevojat e stafit dhe situatën/faktorët e jashtëm	Raportet e vlerësimit dhe vetëvlerësimit Timesheets	1.3.1 Indeksim të vazhdueshëm të nivelit të pagës sipas ndryshimeve ligjore 1.3.2 Krijimi i kushteve normale dhe të sigurta të punës 1.3.4 Plotësimi i formave të timesheets çdo muaj	Mungesa e fondeve për mbajtjen dhe rekrutimin e stafit Mungesa e infrastrukturës për zhvillimin normal të punës
	1.4 Rritja e mirëqënies së stafit	Nr. i kontrolleve mjeksore dhe analizave të realizuara Nr. i seancave të supervizimit të ofruar Nr. i retreat-eve dhe aktiviteteve të shoqërizimit Parandalimi i (burn-out) konsumimit të stafit	Kontrolle mjeksore periodike për çdo punonjës Foto, Axhenda, Materiale të supervizimit, Raporti i ekspertit, Listë pjesëmarrje;	1.4.1 Kontroll periodik shëndetësor 1.4.2 Ofrimi i seancave të supervizimit 1.4.3 Organizim periodik i retreat-eve për shoqërizim dhe argëtim 1.4.4 Udhetime, eskursione, trajtime fizike/estetike; kurse profesionale zhvillimi	Mungesa e fondeve për zhvillimin e aktiviteteve
2. ZHVILLIMI I BURIMEVE					
Qëllimet	Objektivat	Treguesit	Burimet e verifikimit	Aktivitetet kryesore	Supozimet
Qëndrueshmëri afatgjatë financiare e CLR-së	2.1 Diversifikimi/ Sigurimi i të ardhurave nga burime të ndryshme	% e fondeve të ngritura nga shkrimi i projekteve % e fondeve të ardhura nga tenderimet publike	Projekte të shkruara dhe të miratuara Marrëveshjet e nënshkruara Foto/Video/Spote/ Dokumentarë	2.1.1 Shkrim projektsh për të siguruar fonde 2.1.2 Pjesëmarrje në tenderime publike për sigurimin e fondeve 2.1.3. Lobimi me bizneset për sigurimin e fondeve që	Legjislacioni i papërshtatshëm dhe jo-favorizues për biznesin; Mungesa e informacionit/ndjeshmeri

		% e fondeve të ngritura nga aktivitete /fund raising % e fondeve të siguruar nga bizneset	Profilet në media sociale të CLR-së Platforma e ngritur për fundraising	përfshin kërkesa zyrtare, takime të a tët 2.1.4 Organizimi i fundraising dhe aktiviteteve të tjera për të siguruar fonde 2.1.5 Ngritja e platformës së fundraising për CLR	së së biznesit për të dhënë fonde Mangësi në politikat financiare për zhvillimin e fundraising
